



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1031 Prot.

Patos, më 19 03 /2026

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS PËR VITIN
2025.

Ky raport paraqet një përmbledhje përshkruese të veprimtarisë së Këshillit Bashkiak gjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2025, Këshilli Bashkiak ka zhvilluar mbledhje të rregullta, në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisjen vendore dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të Këshillit Bashkiak. Mbledhjet janë thirrur nga Kryetari i Këshillit dhe Kryetari i Bashkisë dhe janë shoqëruar me rend dite të përcaktuar, ku janë shqyrtuar projektvendime të propozuara nga Administrata e Bashkisë.

Procesi vendimmarrës është karakterizuar nga diskutime në komisionet e përherëshme, të cilët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në analizimin paraprak të projektvendimeve dhe kanë hartuar raportet dhe procesverbalet e mbledhjeve. Ky proces ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe profesionalizmit të këshillit. Vendimet janë marrë me shumicë votash, sipas rasteve të parashikuara në ligj.

Një element i rëndësishëm i veprimtarisë së Këshillit Bashkiak për vitin 2025 kanë qenë dëgjesat publike, të cilat janë organizuar për të garantuar përfshirjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës.

Dëgjesat publike janë zhvilluar me qëllim:

- Informimin e qytetarëve mbi projektvendimet me ndikim të gjerë.
- Marrjen e mendimeve, sugjerimeve dhe propozimeve nga komuniteti.
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.
- Përmirësimin e cilësisë së vendimeve përmes konsultimit publik.

Për secilin projektvendim që ka kërkuar konsultim publik është përgatitur njoftimi dhe kalendari i konsultimeve i cili është publikuar në rrjetet sociale të Këshillit dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Njoftimi dhe kalendari kanë pasur në përmbajtje elementët e përcaktuar nga ligji si data, ora, grupet e interesit dhe përshkrimi i projektvendimit.

Në konsultimet publike kanë marrë pjesë edhe anëtarët e Këshillit Bashkiak sipas tematikave të konsultimeve publike. Procesverbalet janë mbajtur nga koordinatori i konsultimeve publike. Konsultimet publike janë realizuar në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë.

Pas mbajtjes së konsultimit publik procesverbali është protokolluar, një kopje gjendet në arkivën e Bashkisë dhe një kopje është postuar në faqen zyrtare të Këshillit të Bashkisë. Sekretari i Këshillit i ka përcjell rekomandimet e marra drejtorive përkatëse. Po ashtu në dëgjesat publike, në kërkesat apo propozimet e ndryshme të qytetarëve përveç takimeve në terren është përdorur varianti online, ku në dispozicion të qytetarëve është vendosur emaili i sekretarisë së këshillit ku ata mund të dërgonin komentet e tyre. Nga kontrolli emailit nuk rezulton ndonjë reagim apo propozim nga ana e qytetarëve për vitin 2025.

➤ **Dëgjesat publike.**

Numri i takimeve për konsultimet publike të organizuara për vitin 2025 është 26 takime.

Regjistri i konsultimeve publike gjendet i publikuar online në faqen e Këshillit të Bashkisë. Për secilin konsultim publik pas përfundimit të tij është publikuar një përmbledhje e aktivitetit së bashku me fotot përkatëse.

Gjatë vitit 2025, dëgjesat publike janë organizuar kryesisht për:

- Projekt-buxhetin e vitit 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm.
- Investimet në infrastrukturë locale.
- Çështje që lidhen me taksat dhe tarifat vendore.
- Etj.

Në këto dëgjesa kanë marrë pjesë përfaqësues të Administratës së Bashkisë, anëtarë të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të komunitetit, organizata lokale dhe qytetarë të interesuar.

Sugjerimet dhe komentet e marra gjatë dëgjesave publike janë reflektuar në disa raste në rishikimin e projekt-vendimeve përpara miratimit përfundimtar. Kjo ka kontribuar në:

- Përcaktimin më të saktë të prioriteteve të investimeve.
- Përmirësimin e shpërndarjes së fondeve.
- Rritjen e pranueshmërisë së vendimeve nga komuniteti.
- Vendime për çështje sociale, ndihmë ekonomike.
- Vendime për çështje arsimit, bursa.
- Etj.

Dëgjesat publike kanë shërbyer si mekanizëm bashkëpunimi ndërmjet këshillit dhe qytetarëve.

➤ **Mbledhjet e Këshillit.**

Gjatë vitit 2025, Këshilli Bashkiak ka zhvilluar mbledhje të rregullta sipas planit vjetor të punës dhe nevojave administrative. Në këto mbledhje janë shqyrtuar dhe miratuar projektvendime që kanë të bëjnë me:

- Miratimin dhe ndryshimet në buxhetin vjetor.
- Programin buxhetor afatmesëm.
- Investime në infrastrukturë dhe shërbime.
- Vendime për çështje sociale, ndihmë ekonomike.
- Vendime për çështje arsimit, bursa.
- Etj.

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar në sallën e Këshillit Bashkiak 14 mbledhje të cilat kanë qënë të hapura për publikun.

- 12 kanë qënë mbledhje të radhës sipas ligjit dhe rregullores.
- 2 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë.

Një pjesë të mbledhjeve janë zhvilluar live në faqen e facebook të Këshillit ndërsa pjesa tjetër është e regjistruar me video-audio. Njoftimi i mbledhjeve dhe publikimi është bërë sipas kriterëve që përcakton ligji.

Nuk ka projektvendimeve të kthyer nga këshilli gjatë vitit 2024.

➤ **Vendimet e Këshillit**

Numri total i vendimeve të miratuara gjatë vitit 2025 është 85 vendime. Nga këto vendime vetëm 20 i janë dërguar Prefekturës së Qarkut Fier për konfirmim ligjor.

Nga këto 20 vendime, 18 vendime janë konfirmuar në përputhje me ligjin ndërsa për një vendim ka ardhur përgjigja se nuk është në përputhje me ligjin, konkretisht vendimi nr. 53 datë 18.08.2025 i cili është shfuqizuar me vendimin nr. 61 datë 22.09.2025 dhe një vendim nuk ka qënë në kompetencën e Prefektit të Qarkut Fier për tu shprehur pasi nuk ishte akt normativ.

➤ **Zbatimi i vendimeve nga administrata.**

Pas zbardhjes së vendimeve ato i kalojnë ekzekutivit për zbatim si dhe në çdo mbledhje pasardhëse është raportuar gjithmonë në lidhje me zbatueshmërinë e tyre. Në pikën e tretë të rendit të ditës është dhënë informacion mbi vendimet e marra nga këshilli, si dhe konfirmimet e tyre nga Prefektura.

➤ **Llojet e vendimeve sipas tematikave të tyre gjatë vitit 2025.**

- Vendime për çështje financiare /tatime/buxheti/ nivel pagash.
- Vendime për çështje projktesh infrastrukturore.
- Vendime për çështje urbane dhe pronash.
- Vendime për çështje sociale, ndihmë ekonomike.
- Vendime për çështje arsimit, bursa.
- Vendime për çështje të ndryshme.

Njoftimi për rendin e ditës si dhe përmbajtja e projektakteve janë publikuar në web si dhe në profilin zyrtar të rrjeteve sociale të Këshillit. Të gjitha vendimet pas zbardhjes së tyre janë dërguar platformës Vendime.al e cila është e ndërlidhur dhe me web-in e Këshillit. Gjithashtu gjatë vitit 2025 Këshilli ka realizuar mbledhje të cilat janë transmetuar live në facebook.

KRYETARI

Armand Ahmetaj



[Handwritten signature in blue ink]